



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. _____ prot.

Belsh më: 26.02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Blerje Automjetet per grumbullimin e mbetjeve urbane”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): automjete -34100000-8

Vlera e fondit limit: 5 811 111 (pesemilion e teteqind e njembedhjetë mijë e njëqind e njembedhjetë) leke pa tvsh.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Belsh, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. ARGUMENTIMI I FONDIT LIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE :

Në zbatim të urdhrit të grupit “Për përlllogaritjen e fondit limit, specifikimeve dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit” Nr .14 , date 14.01.2026 me Nr.110protokolli, të titullarit të autoritetit kontraktor, për objektin e mësipërm, të planifikuar për t’u kryer në programet e investimeve, referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”,

Në bazë të nenit 21, pika 2, neni 35 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Belsh** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

-Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Kriteret e vecanta të kualifikimit janë hartuar nga Komisioni i ngritur me urdher të titullarit Nr .14 , date 14.01.2026 me Nr.110protokolli, referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Hartimi i dokumenteve të tenderit u bë në përputhje me ligjin Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurim Publik” i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar).

Kriteret e përgjithshme përmbajne administrimin e dokumentacionit, ligjor dhe administrative, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, nëpërputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”. Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 02 Datë 09.06.2021 të miratuara nga APP.

II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 8 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022-2023-2024**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Shënim: “Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 41 pika 2 ku përcaktohet se: “Kërkesa të veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 40, 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c. neni 3.1/a, b, c dheneni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2022 sipas kështëve prane bashkëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrorjnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohet dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
 - Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme. Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4/b të vendimit të Këshillit të Ministrave me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë: 4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Njësia përcaktoj kriteret për furnizime të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Sipas këtij neni, Njësia vlerëson se duhen kërkuar dokumentacioni ligjor sipas parashikimit të pikës 4/b të nenit 55 që provon kryerjen e furnizimeve të ngjashme.

- 2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që “Garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve në motorr, kambio dhe sistemin elektrik do të jetë 2 (dy) vite nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përfshihen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)”.

Argumentim: Në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 8 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosë kriteret kualifikimi që lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe që synojnë garantimin e cilësisë dhe funksionalitetit të mallrave që do të prokurohen. Kërkesa për paraqitjen e një vetëdeklarimi lidhur me garantimin e eliminimit pa shpërblim të defekteve në motor,ambio dhe sistemin elektrik për një periudhë 2 (dy) vjeçare nga data e dorëzimit të mjetit, konsiderohet e arsyeshme dhe proporcionale, pasi synon mbrojtjen e interesit publik dhe sigurimin e përdorimit normal dhe të sigurt të mjetit gjatë periudhës së shfrytëzimit nga Autoriteti Kontraktor. Përgjithësi i rasteve kur defekti vërtetohet se është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit është në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe shmang ngarkimin e padrejtë të operatorit ekonomik me përgjegjësi që nuk lidhen me cilësinë e mallit të ofruar.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Belsh.

Argumentim: Bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, nenit 40, pika 8 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. kriteret e kualifikimit duhet të jenë të lidhura me realizimin e kontratës dhe të sigurojnë përmbushjen e plotë të detyrimeve kontraktuale nga operatori ekonomik. Kërkesa që operatori ekonomik, në rast se shpallet fitues, të mbulojë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Belsh, lidhet drejtpërdrejt me përfundimin ligjor dhe faktik të objektit të kontratës. Pa kryerjen e këtij veprimi, Autoriteti Kontraktor nuk mund të konsiderohet pronar i ligjshëm i mjetit dhe kontrata nuk realizohet plotësisht. Ky kriter nuk krijon diskriminim dhe zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke garantuar transparencë dhe siguri juridike për Autoritetin Kontraktor.

2.3.4 Për mjetin duhet të paraqiten fotografi të qarta nga të gjitha anët dhe origjinale.

Argumentim: Në përputhje me nenin dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020, nenit 40, pika 6/b (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kërkojë informacion dhe dokumentacion që shërben për verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike. Kërkesa për paraqitjen e fotografive të qarta dhe origjinale të mjetit nga të gjitha anët synon verifikimin paraprak vizual të gjendjes fizike, integritetit dhe përputhjes së mjetit me përshkrimin teknik të kërkuar në dokumentet e tenderit. Ky kriter nuk është kufizues, nuk kërkon investime shtesë nga operatorët ekonomikë dhe shërben si mjet mbështetës për vlerësimin objektiv dhe transparent të ofertave.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojë vendndodhjen e mjetit (adresën e saktë) si dhe të dhënat përkatëse të mjetit me qëllim që Autoriteti Kontraktor Bashkia Belsh të bëjë verifikimin fizik të gjendjes teknike dhe vizuale të mjetit përpara shpalljes së ofertës fituese për operatorët ekonomik të kualifikuar sipas renditjes. Përben kusht për skualifikim nëse nga verifikimi vërehet se kemi mospërputhje të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Belsh.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponueshmërinë e tyre për dërgimin e mallit në vendet e përcaktuara nga AK sipas kërkesave të tij në funksion të mbarëvajtjes së proceseve të punës. Kërkesa që operatori ekonomik të vetëdeklarojë vendndodhjen e mjetit dhe të vërë në dispozicion mjetin për verifikim fizik dhe vizual nga Autoriteti Kontraktor synon garantimin e vërtetësisë së të dhënave të paraqitura në ofertë dhe shmangien e situatave të mospërputhjes ndërmjet dokumentacionit dhe gjendjes reale të mjetit, Parashikimi se ky verifikim përbën kusht për skualifikim në rast mospërputhjeje është në përputhje me parimin e barazisë, transparencës dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë, duke garantuar që kontrata t’i jepet një operatori që realisht përmbush kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Referuar procesverbalit nr 454 prot date 16.02.2026 janë hartuar në varësi të objektit të kontratës nga Komisioni i hartimit të fondit limit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të vecanta të kualifikimit krijuar me Urdhër, ku bashkëlidhur ka dërguar kriteret e vecanta të kualifikimit, specifikimet teknike të dërguara, ofertat për studimin e tregut plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik¹”, dhe nenin 40 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). *Specifikimet teknike, të hartuara për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë elementet më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, dhe çdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standarteve ndërkombëtare për automjetet.*

KOMISIONI I KRITEREVE TË VECANTA TË KUALIFIKIMIT:

NJËSIA E PROKURIMIT: